

**NJOFTIM**  
**Nr. 9936/1, datë 31.5.2023**

**PËR ORGANIZIMIN E PROCEDURËS KONKURRUESE PËR PËRZGJEDHJEN E ZHVILLUESIT TË ZONËS SË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK NË KOPLIK, MALËSI E MADHE**

**1. Institucioni përgjegjës**

**Emri dhe adresa e institucionit përgjegjës:**

**Emri:** Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

**Adresa:** Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë.

**Tel./Fax:** +355 42 28 111 33

**E-mail dhe personi i kontaktit:** Evisa.Hasani@financa.gov.al

**Faqja e internetit:** [www.financa.gov.al](http://www.financa.gov.al); [www.aida.gov.al](http://www.aida.gov.al)

**2. Objekti i kontratës**

Ndërtimi, zhvillimi, mirëmbajtja dhe operimi i Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik, në Koplik, Malësi e Madhe.

**2.1 Përshkrimi i shkurtër i kontratës**

Ndërtimi, zhvillimi, mirëmbajtja dhe operimi i Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik, në Koplik, Malësi e Madhe.

**Burimi i financimit:** Nga burimet financiare të zhvilluesit të shpallur fitues nga procedura konkurruese.

**2.2 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:** 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet.

**2.3 Vendndodhja e objektit të kontratës:**

Zona e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik Koplik, Malësi e Madhe, ndodhet në veri të qytetit të Koplikut. Sipërfaqja prej **61 (gjashtëdhjetë e një)** ha i përket zonës kadastrale nr. 2220 dhe nr. 2221, Koplik. Kjo zonë është shpallur me VKM-në nr. 463, datë 22.6.2016, “Për shpalljen e Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik në Koplik, Malësi e Madhe”, të ndryshuar.

Zona e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik shtrihet në pjesën veriore të Shkodrës, 6 km nga kufiri me Malin e Zi, në juglindje të porteve të mëdha të Triestes (zona e lirë tregtare në verilindje të Italisë, në kufi me Kroacinë), Koperit (10 milje në jug të Triestes në Slloveni), Rijekes (porti më i rëndësishëm Dalmatian, 35 milje në juglindje të Triestes, në krye të gjirit të Kvarnerit në Republikën Kroate), Splitit (porti i dytë detar më i rëndësishëm, i cili ndodhet në mes të vijës bregdetare 1,200 milje larg Kroacisë).

**3. Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik**

**3.1 Kriteret e kualifikimit dhe vlerësimit,** sipas shtojcës nr. 3.

**3.2 Sigurimi i ofertës:**

Ofertuesi, paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, kur kërkohet, sipas shtojcës 5.

Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është **15,000,000 lekë (pesëmbëdhjetë milionë).**

**4. Procedura**

**4.1 Lloji i procedurës:**

|                              |                                               |
|------------------------------|-----------------------------------------------|
| <b>Procedurë konkurruese</b> | <b>Procedurë me aplikim, në pronë private</b> |
| <input type="checkbox"/>     | <input checked="" type="checkbox"/>           |

#### 4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

| Nr. | Kriteri                                                                        | Pikët |
|-----|--------------------------------------------------------------------------------|-------|
| 1   | Propozimi teknik për ndërtimin e zonës                                         | 25    |
| 2   | Ndikimi mjedisor                                                               | 10    |
| 3   | Ndikimi social                                                                 | 15    |
| 4   | Koha e përfundimit të investimit                                               | 10    |
| 5   | Kapaciteti financiar dhe mundësia e financimit të projektit (plani i biznesit) | 40    |
|     | <b>TOTALI</b>                                                                  | 100   |

Institucioni përgjegjës duhet të specifikojë pikët për çdo kriter vlerësimi të vendosur, sipas metodologjisë së përcaktuar në shtojcën nr. 6, për çdo kriter në mënyrë specifike.

**4.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**  
**datë 10.7.2023, ora: 10:00**

**Vendi:** Në ambientet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, sala e mbledhjeve, kati i katërt.

**4.4 Periudha e vlefshmërisë së ofertave: 150** (e shprehur në ditë)

**4.5 Gjuha/ët për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

|        |                          |                                                                                   |                                     |
|--------|--------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|
| Shqip  | <input type="checkbox"/> | Anglisht                                                                          | <input checked="" type="checkbox"/> |
| Tjetër |                          | Në rast dorëzimi në gjuhë të huaj, dokumentet duhet të jenë të përkthyer në shqip |                                     |

#### 5. Informacione plotësuese

##### 5.1 Dokumente me pagesë:

|    |                                     |    |                          |
|----|-------------------------------------|----|--------------------------|
| Po | <input checked="" type="checkbox"/> | Jo | <input type="checkbox"/> |
|----|-------------------------------------|----|--------------------------|

Nëse Po

|         |       |       |       |
|---------|-------|-------|-------|
| Monedha | _____ | Çmimi | _____ |
|---------|-------|-------|-------|

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së DPK-së tek ofertuesit. Ofertuesit e interesuar kanë të drejtë të kontrollojnë DPK-në para blerjes së tyre.

##### 5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e DPK-së)

Ofertat do të hapen në ambientet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, sala e mbledhjeve, kati i katërt.

Dokumentet do të tërhiqen pranë:

MFE-së, në zyrën e personit të kontaktit; ose

Në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;

dhe

Në faqen zyrtare të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve.

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi: **5.6.2023.**